



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Miratimi i projektprogramit të punës së Kuvendit për periudhën 2 shtator - 18 tetor 2019
Miratimi i projektkalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 2 - 20 shtator 2019.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Zëvendëskryetare e Kuvendit
Nyslim Murizi -	Zëvendëskryetar i Kuvendit
Elisa Spiropali –	Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Rudina Hajdari -	Kryetare e Grupit Parlamentarë Demokrat / Kryetare e Komisionit për Integrimin European
Nimet Musai -	Kryetar i Grupit Parlamentarë të Pavarur
Adriatik Alimadhi -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partive të Djathta
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Arben Ahmetaj -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Niko Peleshi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Enver Rroshi -	Kryetar i Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë
Fatjona Dhimitri -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Marrin pjesë:

Mimoza Pano - Drejtore e Shërbimit të Seancës Plenare

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi - Të nderuar anëtarë të Konferencës së Kryetarëve, duke Ju uruar një fillim të mbarë në këtë sesioni të ri parlamentar, po hapim mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve me rend dite, miratimin e programit të punës së Kuvendit për periudhën 2 shtator deri 18 tetor 2019 dhe miratimin e kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 2 – 20 shtator 2019.

Besoj se jeni njohur me projektprogramin dhe projektkalendarin. Të dyja materialet janë hartuar si zakonisht sipas ndryshimeve të Rregullores së Kuvendit që miratuam në mbyllje të sesionit të kaluar, pasi me të gjitha ndryshimet e bëra ato nuk prekin hartimin e këtyre dy dokumenteve parlamentare.

Projektprogrami përfshin të gjitha çështjet e depozituara në Kuvend të mbetura që në sesionin e kaluar, si edhe ato të reja që janë depozituar pas mbylljes së tij.

Në Kuvend janë depozituar pas mbylljes së sesionit 6 dekrete për rishqyrtim ligji nga Presidenti, 5 projektligje, 4 prej të cilëve janë ratifikime, 1 vendim i Këshillit të Ministrave për zgjedhjen e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ju rikujtoj se deri tani kanë mbetur pa raportuar në Kuvend institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si edhe Këshilli i Ministrave për gjendjen në shërbimin civil, si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në këtë projektkalendar është parashikuar raportimi i Këshillit të Ministrave për gjendjen në shërbimin civil, pasi nuk u bë në seancën e fundit. Ndërsa për dy raportimet e tjera komisionet përgjegjëse të përshpejtojnë punën që t'i mbyllim sa më parë. Fjala është për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe për Kontrollin e Lartë të Shtetit. Projektkalendari përfshin veprimtarinë në komisione dhe në seanca plenare. Janë parashikuar gjithsej këtë muaj 3 seanca plenare, përkatësisht: kjo e ditës së sotme, që do të jetë në orën 18.00, hapja e sesionit të ri parlamentar, më 12 shtator 2019, në orën 10.00, ditën e enjte dhe më 19 shtator, ora 10:00, ditën e enjte. Të enjten e parë, pra në datën 5 nuk do të ketë seancë plenare, jo vetëm se është festë zyrtare Shenjtërimi i Nënë Terezës, por edhe që komisionet të bëjnë gati projektligjet për seancën plenare. Gjatë gjithë javës do të ketë punë vetëm në komisione.

Përpara se të kalojmë në sugjerimet që mund të keni, dua t'u rikujtoj veçanërisht kryetarëve të komisioneve se pas ndryshimit të Rregullores së Kuvendit raporti i komisionit për shqyrtimin e çështjeve hartohet jo më vonë se 4 ditë nga përfundimi i shqyrtimit. Pra, duhet ta keni parasysh këtë element të ri të Rregullores. Në rastin kur projektligji shqyrtohet

me procedurë të përshpejtuar afati i paraqitjes së raportit është të paktën 2 ditë përpara seancës plenare, pra është dyfishuar për ligjet e zakonshme, prandaj kryetarët e komisioneve duhet ta kenë parasysh.

Gjithashtu ju rikujtoj se rendi i ditës së seancës plenare me ndryshimet e reja do të bëhet publik si rregull 7 ditë përpara, por jo më vonë se 2 ditë para datës së caktuar për seancë plenare. Prandaj edhe një herë u rikujtoj kryetarëve dhe kryetareve të komisioneve që të zbatohet me rigorozitet rregulli i mësipërm të cilin e kemi miratuar bashkërisht për të mos u bërë pengesë për mbarëvajtjen e punimeve të rendit të ditës së seancës plenare. Komisionet të punojnë jo vetëm projektligjet që janë parashikuar në seancë plenare, por edhe ato që janë në punë në komisione pasi këto të fundit do të parashikohen për seancat plenare në 3 - javëshin e ardhshëm, i cili vjen shumë shpejt. Këtu dy sugjerime kisha.

Fjala është për ju, nëse keni sugjerime si për projektprogramin, ashtu edhe për projektkalendarin që keni përpara.

Kush e kërkon fjalën?

Po, zonja Hajdari.

Rudina Hajdari - Mirëmëngjesi të gjithëve!

Ju uroj një sesion të mbarë!

Kemi përpara shumë gjëra për të realizuar këta 6 muaj. Pashë me vëmendje kalendarin dhe kam disa pyetje, më tepër janë teknike, ndoshta zonja Pano do të na ndihmojë për këtë pjesë.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”” është një propozim i prapambetur. Kush e ka bërë këtë propozim, sepse si kryetare e Komisionit të Posaçëm nuk jam në dijeni për një gjë të tillë? Do të doja pak më tepër detaje rreth këtij ligji. Mund të m'i jepni pak më vonë.

E dyta, si kryetare e Grupit Parlamentar Demokrat kam pasur një shqetësim në lidhje me Komisionin për Reformën Zgjedhore. Kam folur edhe me kryetarin e Partisë Socialiste për të parë një lëvizje të vogël brenda komisionit në mënyrë që të funksionojë sa më mirë.

Zoti Kryetar, zoti Balla është informuar për këtë gjë, prandaj nuk do ta shtjelloj më

tepër, por do të donim një zgjidhje sa më të shpejtë në mënyrë që të fillojmë sa më parë punën e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore, sepse do të jetë një nga komisionet më të rëndësishme në sesionin në vijim.

Pjesa e tretë e diskutimit tim konsiston në faktin se gjatë verës ne patëm një seancë të fundit në parlament, ku u miratuan shumë projektligje në një mënyrë shumë të shpejtë dhe,

pavarësisht shqetësimeve që mund të kemi me Presidentin, ai ka rikthyer disa ligje në parlament, ndaj do të doja që ju si Kryetar i parlamentit t'i rishikonit me vëmendje kërkesat, shpjegimet apo ankesat që Presidenti ka bërë në lidhje me këto projektligje.

Janë plot 11 projektligje dhe disa prej tyre, në fakt, janë shoqëruar me qortime të drejta. Patjetër që me këtë punë do të merren edhe ekspertët, por opozita do të bëjë rolin e saj, nëse ka nevojë për amendamente apo për rishikim të ligjit apo për hapësira të mundshme në praktikën parlamentare se çfarë mund të bëjmë.

Do t'i propozoja Kryetarit të Parlamentit t'i shohë me vëmendje dhe mos t'i miratojmë në mënyrë të përsheptuar dhe t'i hedhim poshtë të gjitha dekretet që ka sjellë Presidenti në parlament.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Urdhëroni për shpjegimet!

Mimoza Pano – Lidhur me depozitimin në programin e punës së Kuvendit për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor, theksoj se kjo nismë është depozituar në dhjetor të vitit 2018 nga anëtarët e maxhorancës në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore. Kjo ka qenë pjesë e programit të punës dhe ka pasur edhe kërkesë për të gjetur konsensusin për ta votuar në seancë plenare. Ky është produkt i punës së atij komisioni. Duhet theksuar se është në procedura parlamentare nëse komisioni i posaçëm i reformës do ta marrë sërish në konsideratë e ka të hapur rrugën për të vijuar me atë nismë. Ne jemi të detyruar ta pasqyrojmë, sepse është një dokument i depozituar në Kuvend.

Për sa i përket dekreteve të Presidentit, mund t'ju them vetëm këtë, që në ndryshimet e fundit në Rregullore kemi parashikuar afat për shqyrtimin e dekreteve të Presidentit, kështu që, duke respektuar afatin që ka Rregullorja, neni i ri për shqyrtimin e dekreteve të Presidentit për rishqyrtimi ligji, kemi parashikuar që nga 9 dekretet, 4 të shqyrtohen në seancën e datës 12 dhe 5 në seancën e datës 19, me qëllim që të jemi në rregull me afatin e Rregullores. Nëse komisionet vlerësojnë se duhet më shumë punë, le të vijojë puna, por ne jemi të detyruar t'i parashikojmë në kalendar.

Brenda 4 javëve nga data e depozitimit në Kuvend, komisioni përgjegjës duhet të përgatisë raportin për shqyrtimin në seancë plenare. Dekretet janë të korrikut dhe të gushtit, kështu që jemi të detyruar t'i parashikojmë në kalendar.

Faleminderit!

Adriatik Alimadhi – Unë bie dakord me mendimin e zonjës Hajdari.

E para, përderisa data e depozitimit të një grupi deputetësh të ish-opozitës është 18.12.2018, do të doja që të gjitha materialet t'i kishim në dispozicion.

E dyta, duke vendosur këtë datë dhe duke parë se është propozuar nga ish-deputetët, do të kërkoja që ta fillonim seancën plenare me kërkesat e tyre, duke parë edhe situatën aktuale politike.

E keni vendosur në pikën 6. Por, duke parë situatën politike, kur opozita që i ka bërë këto propozime është në rrugë, ta fillonim seancën me pikën e parë “Për ndryshime në Kodin Zgjedhor”.

Taulant Balla – Ndoshta u keqkuptua nga informacioni që dha zonja Pano.

Në sesionin e vjeshtës të vitit 2018, teksa afrohej afati 6-mujor, që paraprinte zgjedhjet vjetore të vitit 2019 për të futur në proces edhe deputetët e opozitës së atëhershme, deputetët e maxhorancës, që vazhdon të jetë maxhorancë edhe sot dhe do të vazhdojë të jetë, kanë depozituar këtë dokument, i cili tashmë është dokument pune në Komisionin e Reformës Zgjedhore.

Rregullorja e Kuvendit, sa kohë që deputeti propozues apo grupi i deputetëve propozues nuk është tërhequr nga drafti, e ripasqyron atë në të gjithë kalendarët dhe në të gjitha programet vijuese, por, në funksion të asaj që zoti Alimadhi ngriti si çështje, për kujtesë, sa herë fillon një sesion i ri parlamentar, kryetarët e grupeve parlamentare ose një person i rekomanduar prej tyre, në një kohë jo më gjatë se 10 minuta, kanë të drejtën e fjalës në fillim të sesionit për parashtrimin e të gjitha objektivave të tyre për këtë sesion.

Pra, ju zoti Alimadhi, si kryetar i grupit më të vogël, mund të diskutoni i pari, më pas zoti Nimet, zonja Hajdari dhe më pas unë apo dikush i rekomanduar prej meje. Sot keni të drejtën që, në fillim të sesionit, të mbani fjalën për të parashtruar objektivat e grupit tuaj parlamentar.

Një gjë tjetër, që doja të thosha për dekretet, është se dekretet tashmë kanë një afat.

Kjo gjë është bërë edhe për t'i vënë fre Kuvendit që lidhur me dekretet e Presidentit të Republikës, të ketë një afat.

Në historinë e vjetër dhe të re të këtij Kuvendi, të paktën gjatë kohës së drejtimit të tij nga zoti Ruçi, nuk ka ndodhur më, por në kohë të kaluara vinte një dekret nga Presidenti i

Republikës, mbahej në sirtar, dhe Kryetari i Kuvendit nuk e nxirrte për ta shqyrtuar. Kjo nuk është një e drejtë që Kuvendi ta ketë në Kushtetutë.

Ndryshimet e reja në Rregulloren e Kuvendit janë bërë, sepse, në fund të fundit, edhe ky afat i vendosur është rekomandim nga vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe ne jemi të detyruar që dekreteve të Presidentit të Republikës t'u japim një përgjigje brenda afatit të përcaktuar.

Në fakt, unë do të sugjeroja që të ishin të gjitha në një seancë, në atë të datës 12, por, nisur nga fakti se afati që paraprin është 7-ditor, do t'u sugjeroja shërbimeve të Kuvendit që të bëjmë një mbledhje të posaçme me kryetarët e komisioneve sot, nesër, ose kur të jetë e mundur, për të shpjeguar më së miri afatet e reja të përcaktuara nga Rregullorja e re e Kuvendit. Datat 12 dhe 19 janë fizible për t'iu përqasur sadopak afatit, sepse në çdo rast, në qoftë se unë do të isha President i Republikës, Kuvendi e ka shkelur afatin 4-javor, pra komisioni nuk e ka, po do ta kapim, unë do ta ktheja përsëri dhe do të thosha: prisni, se vetë Kuvendi ka shkelur Rregulloren e tij. Kështu që të mos i japim asnjë institucioni të drejtën për t'u... Por ne të parët duhet të respektojmë afatet që kemi.

Faleminderit!

Adriatik Alimadhi – Në fakt, unë kam diçka serioze. Duke qenë se jemi pjesë e vazhdimësisë së listës dhe, tashmë, jemi deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, do të sugjeroja që ne t'i kishim të gjitha praktikrat dhe mendimet që një grup deputetësh i opozitës ose edhe i maxhorancës, i ka negociuar në vazhdimësi për ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Përndryshe, i bie që ju punoni me dy mendësi: me mendësitë e tyre ose thëniet e mendimet e tyre, ndërsa ne jemi thjesht këtu duke dhënë mendime ose duke u tallur me ne, si me thënë. Ndaj mirë do të ishte ne të njiheshim me këto materiale, me këto kërkesa, sepse ndoshta mund të kishim edhe mendime të tjera, pra nuk do t'i kishim mendimet e deputetëve të opozitës, që tashmë nuk janë në këtë parlament.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taulant Balla – Faleminderit!

Tani, që të jemi të qartë, propozime...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Propozimet e ish-deputetëve, nuk e di cilat janë, por ato kanë rënë automatikisht, sepse nuk është më propozuesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë vazhdoj të jem këtu në Kuvend dhe, për pasojë, propozimi im nuk bie, madje propozimi im dhe i kolegëve të mi ka shkuar në Komisionin e Reformës Zgjedhore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqenëse jemi këtu, zoti Alimadhi, unë e kuptoj, ndoshta është momenti, edhe në kuadër të një rregullimi, që e propozoi zonja Hajdari, ta zgjeronim përbërjen e Komisionit të Reformës Zgjedhore edhe me një përfaqësues nga grupi i ri parlamentar i krijuar, me qëllim që të gjitha grupet e opozitës të jenë të përfaqësuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, për seancën plenare të datës 12 të bëjmë gati një projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin iks “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore””, ku numri i anëtarëve të mos jetë më pesë me pesë (sa e kemi), por të bëhet gjashtë me gjashtë, ku të përfshihet edhe një përfaqësues nga grupi juaj parlamentar.

Atje, i nderuar zoti Alimadhi, keni të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të punës së bërë. Unë dua t’i falënderoj këtu zonjën Hajdari dhe zotin Gjiknuri që gjatë kësaj kohe kanë punuar, nuk është se kanë ndenjur, por jemi në një fazë ku duhet ta rivitalizojmë, së pari, kontratën e bashkëpunimit me ambasadat që kanë shfaqur interes, sepse dikush është tërhequr, dikush është vetofruar.

Së dyti, dua të kujtoj këtu që Ditën e Pavarësisë e kemi afatin përfundimtar të këtij komisioni, ndaj do të ishte edhe në nderin e këtij parlamenti që më në fund të respektojë afate, të cilat i vendos vetë.

Unë kam qenë kryetar i këtij komisioni nga viti 2014 deri në vitin 2017 dhe të vetmen gjë që kam bërë, për fat, jo sepse kam dashur unë, por edhe për mungesë të konsensusit nga pala tjetër, ka qenë vetëm shtyrja e afateve. Mjaft më! Këtë gjë të mos e bëjmë edhe me ju!

Kjo ishte një nga çështjet e ngritura në fjalën tuaj, por besoj se edhe nga kolegët e tjerë të opozitës, edhe nga ana ime është dakordësia e plotë që edhe grupi juaj i ri, i ngritur në korrik, të jetë i përfaqësuar në Komisionin e Reformës Zgjedhore.

Nimet Musai – Faleminderit, zoti Kryetar!

Në radhë të parë, dua t'ju falënderoj Juve, si Kryetar, suksese dhe mbarësi për këtë legjislacion, kryetarët e komisioneve dhe të gjithë kolegët deputetë të këtij Kuvendi, si dhe administratën për nisjen me këmbë të mbarë, duke parë edhe diskutimet e kolegëve!

Normalisht, e fillojmë andej nga na dhemb më shumë se çdo gjë, nga reforma zgjedhore. Më vjen mirë që propozimi korrekt për t'u shtuar nga gjashtë me gjashtë, që është ky komision, në shtatë me shtatë; nuk ka asnjë problem, përkundrazi është kënaqësi.

Gjithashtu, do të më vinte që komisioni (tre muaj kohë kemi, jemi në fillim të shtatorit dhe deri në fund të nëntorit, që mbaron) të mbledhë në mënyrë të menjëhershme për të marrë

në konsideratë të gjitha sugjerimet dhe vlerësimet për punën. Vlerësoj këtu edhe propozimin që bëri zoti Murrizi në mbledhjen e fundit që në rendin e ditës si pikë e tretë hyri edhe kërkesa

jonë për ta rishqyrtuar menjëherë. Kështu që ju uroj suksese të gjithëve bashkërisht!

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Dua të shtoj vetëm diçka lidhur me atë çfarë tha zoti Alimadhi.

Së pari, dua ta siguroj që ai komision ka dy kryetarë dhe për çdo gjë që do të bëhet (unë e pyeta për këtë projektligj, pasi nuk e dija nëse është projektligj i ri, i propozuar nga deputetët aktualë kohët e fundit apo ishte një ligj i prapambetur, por, me sa duket, është një ligj i prapambetur nga muaji dhjetor dhe të jesh i sigurt që, në asnjë moment, nuk do të kalojë asgjë pa pasur transparencë të plotë, sepse do të duhet dakordësia e bashkëkryetares dhe kur themi këtë, i bie e gjithë opozitës.

Pra, pa e diskutuar me ju dhe pa qenë ju dakord ... Mendoj se propozimi i zotit Balla për të pasur një vend shtesë do të ishte gjëja e duhur. Më tej ne do të vazhdojmë të mundohemi gjatë gjithë kohës që të kemi sa më shumë konsensus për reformën zgjedhore, sepse pa konsensusin e të dyja palëve ne nuk do të arrijmë dot ta përfundojmë. Tani kjo do të jetë një

detyrim ndërkombëtar dhe jo vetëm detyrim i Kuvendit. Unë mendoj që ne duhet ta plotësojmë dhe miratojmë këtë reformë, sepse do të jetë e vetmja gjë që do ta zgjidhë krizën për vitet e ardhshme.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Në pikën 13 të Kalendarit kemi projektligjin “Për ndryshimet klimatike”. Do të kërkoj që ky projektligj t'i kalojë për mendim edhe Komisionit të Sigurisë për arsyen e thjeshtë që

çështjet e klimës janë tanimë çështje të sigurisë. Kjo diskutohet pothuajse në të gjitha konferencat ndërkombëtare. Kështu që, mendoj se edhe Kuvendi duhet të fillojë të ndryshojë qasje. Në mënyrë që deputetët e këtij komisioni të jenë sa më në dijeni, do të dëshiroja që ky projektligj i ri t'i kalojë për mendim edhe komisionit tonë. Natyrisht, do të jemi brenda afateve që ju keni parashikuar për të qenë në parlament.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Atëherë, kam dy-tre komente.

Së pari ka të bëjë me çështjen që mori diskutimin më të gjerë për sa i përket nismës që ka marrë grupi i maxhorancës. Të jetë e qartë se çdo projektligj që depozitohet në Kuvend nuk kalon as në program dhe as në kalendar pa kaluar në komision. Në rastin konkret është Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore. Pra, jo vetëm ky projektligj, por kushdo deputet

që ka mendim, propozim apo sugjerim për ndryshimin e Kodit, mund t'i depozitojë ato në Kuvend dhe më pas të gjitha këto do t'i kalojnë Komisionit për Reformën Zgjedhore. Është ky

komision që do të japë verdiktin dhe kur të bëhet gati, do të përfshihet në rendin e ditës sipas vendimit të Kuvendit. Kjo duhet të jetë e qartë përfundimisht në mënyrë që të mos ketë keqkuptime për këtë çështje. Zot i kësaj pune është komisioni *ad hoc*. E drejtë ekskluzive e deputetëve, kushdoqoftë ai, është që ky komision lejon të kontribuojnë me grupe parlamentare apo në mënyrë individuale me propozime, por të gjitha propozimet do të adresohen nga shërbimet e Kuvendit te komisioni dhe më pas është komisioni ai që do t'i filtrojë. Bien dakord apo jo grupet apo deputetët, është çështje tjetër. Nëse janë dakord, do t'i nënshtrohen verdiktit që ka dhënë komisioni i reformës, në të kundërt do t'i nënshtrohen seancës plenare. Miratohen apo jo, është e drejtë e deputetëve.

Së dyti, për dekretet e Presidentit duhet të jemi rigorozë. Bëri një sqarim zotoi Balla. Janë katër nene, që kanë të bëjë me marrëdhëniet e institucionit të Presidentit me institucionin e Parlamentit, me të cilët nga pikëpamja procedurale ne duhet të jemi seriozë. E para, të gjitha dekretet e Presidentit bëhen automatikisht pjesë e programit. Nuk është nevoja as për seancën dhe as për Konferencën e Kryetarëve. Kjo është e shprehur në nenin 86, pika 1. E dyta, neni 86, pika 2, e Rregullores kërkon që dekretet e Presidentit, pasi kalojnë në filtrin e komisionit përgjegjës, të futen automatikisht në rendin e ditës të mbledhjes më të parë. E treta, në neni 86, pika 4, thuhet që komisionet nuk kanë ekskluzivitetin t'i zvarrisin dekretet e Presidentit pambarim, por kanë vetëm 4 javë kohë nga dita e depozitimit. Kjo është Rregullorja që kemi miratuar.

Së treti, pjesë e rendit të ditës për shqyrtim në seancë plenare nuk mund të bëhen pa kaluar 48 orë nga momenti i mbarimit të punës në komision. Për këto nga pikëpamja procedurale të jemi të gjithë të qartë. Nuk ka nevojë për ekuivoke apo diskutim, sepse i kemi diskutuar kur i kemi miratuar dhe duhet të tregohemi seriozë për këtë çështje.

Për sa i përket përmbajtjes, zonja Hajdari bëri një koment që unë si Kryetar Kuvendi duhet të shikoj problemin që Kryetari i Kuvendit nuk ka të drejtë të vërë veto për miratimin ose mosmiratimin e dekreteve të Presidentit.

Kjo është ekskluzivitet i dy gjërave: i komisioni përkatës që shqyrton dekretin (janë të mirëpritur dhe u rekomandoj drejtuesve të komisioneve që kanë këto dekrete t'i shikojnë me përgjegjësi, profesionalizëm dhe objektivitet për ato komente që ka bërë Presidenti dhe më pas të japin verdiktin e tyre), dhe i çdo deputeti për të bërë komente dhe për të dhënë votën pro ose kundër për dekretet e Presidentit. Këto komente kisha.

Së fundi, sot është dita kur fillojnë punimet e Kuvendit. Do të miratohen programi dhe kalendari. Unë si Kryetar Kuvendi do të mbaj një fjalë për çfarë është realizuar ose jo në

sesionin e kaluar dhe cilat janë objektivat e këtij sesioni sipas këndvështrimit tim. Secili nga kryetarët e grupeve është i lutur, nëse dëshiron, sipas radhës që tha zoti Balla, të flasë në seancën e parë të sesionit të ri për të bërë bilancin sipas këndvështrimit të grupit të vet, qoftë për sesionin e kaluar, qoftë edhe për objektivat e këtij sesioni të ri parlamentar. Dëshironi apo jo ta merrni fjalën është dëshira juaj, por unë këtë doja t'ju thosha.

Faleminderit dhe ditën e mirë!

Punë të mbarë dhe mirupafshim në orën 18:00!

MBYLLET MBLEDHJA